



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Prezantimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” (*Komision për dhënie mendimi*);
2. Prezantimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Komision për dhënie mendimi*);
3. Prezantimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar” (*Komision për dhënie mendimi*);
4. Prezantimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”(*Komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Nusret Avdulla, Bujar Çela, Gëzim Ademaj, Shkëlqim Bullari, Mirela Pitushi dhe Edona Bilali.

Mungojnë:

Helidon Bushati, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Flamur Hoxha, Lefter Gështenja, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Luan Baçi, Qani Xhafaj dhe Lodovik Hasani.

Të ftuar:

Ervin Mete – ministër i Financave dhe Ekonomisë

Vasilika Vjero – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Përshëndetje, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Në radhë të parë, më lejoni t'ju shpreh keqardhjen që nuk mundëm të mbledheshim sot në orarin e parashikuar, 14:00, për ta zhvilluar fizikisht dhe normalisht mbledhjen në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë. Të gjithë ju kolegë që ishit prezentë e patë që nuk u lejuam të futeshim në sallën e komisionit për të zhvilluar mbledhjen, kështu që në bazë të një vendimi të Konferencës së Kryetarëve mbledhjen po e zhvillojmë *online*.

Sot në rendin e ditës kemi prezantimin e projektbuxhetit për vitin 2024. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është zoti Laert Duraj. Për prezantimin e projektligjit i pranishëm është ministri i Financave, zoti Ervin Mete.

Zoti Ministër, mirë se erdhët!

Unë ju falënderoj, pasi pavarësisht agjendës suaj të ngjeshur dhe të spostimeve të herëpashershme të orareve, jeni sot këtu me ne për të na bërë prezantimin e rëndësishëm të buxhetit për vitin 2024.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi prezantimin e tri projektligjeve të paketës fiskale: projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””; projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”” dhe projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Për të tria këto projektligje ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është zoti Laert Duraj.

Për prezantimin e projektligjeve të paketës fiskale e pranishme është zonja Vasilika Vjero, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, prezantimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Ju lutem, shkurtimisht pikat kryesore të këtij projektbuxheti dhe pak më në detaje për ato që janë linjat e komisionit që përfaqësojmë ne në lidhje me infrastrukturën, bujqësinë dhe turizmin.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Së pari, ju falënderoj për mundësinë për ta prezantuar projektbuxhetin edhe në këto kushte të pazakonta!

Projektbuxheti i vitit 2024 synon mbështetjen e rritjes së mëtejshme ekonomike përmes mbështetjes së investimeve publike, shpërndarjes së mirëqenies për qytetarët, punësim më cilësor, mbrojtje sociale për shtresat në nevojë, duke vijuar njëkohësisht me konsolidimin e mëtejshëm fiskal nëpërmjet së cilit synohet që borxhi publik vitin e ardhshëm të zbresë për herë të parë nën nivelin 60%, që nga viti 2011.

Rritja ekonomike për vitin 2023 është rishikuar në rritje, nga 2,6% që ishte projekcioni fillestar, në 3,7%. Është një rishikim që është marrë në rritje si nga Banka Botërore, ashtu edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Nisur nga momenti pozitiv që po kalon ekonomia, projeksionet janë për një rritje ekonomike prej 3,8% për vitin e ardhshëm, si edhe një rritje mesatare prej 4% në afatmesëm.

Së fundi, kemi pasur një vlerësim shumë pozitiv nga FMN-ja, e cila vlerësoi se ekonomia shqiptare shfaqet si një nga ekonomitë më rezistente të rajonit në përmbylljen e saj me një sërë sfidash, ndërkohë që perspektiva ekonomike në vazhdim mbetet pozitive.

Edhe nga Agjencia Ndërkombëtare “Standard&Poor’s” patëm një rishikim të perspektivës së vlerësimit të Shqipërisë, nga perspektivë e qëndrueshme në perspektivë pozitive. Edhe ky është një rishikim pas gati 7 vjetësh, çka është një tregues i progresit dhe i trendit pozitiv që po kalon ekonomia.

Po ashtu, dalja nga Lista Gri e FATF/MONEYVAL-it pritet të sjellë një sërë ndikimesh pozitive në klimën e biznesit, në zhvillimin ekonomik, në investime, edhe sa i përket lehtësimit të kostove të transaksioneve financiare në sistemin bankar brenda dhe jashtë vendit. Në këtë situatë pozitive projektbuxheti, që projektohet në nivelin që i tejkalon 7 miliardë euro, synon që të reflektojë këtë fazë të re të zhvillimit të ekonomisë dhe ta mbështesë më tej rritjen ekonomike.

Të ardhurat buxhetore në raport me prodhimin e brendshëm bruto në periudhën afatmesme do të vlerësohen mesatarisht në 27,8% të GDP-së, kjo bazuar kryesisht në përmirësimin e administrimit fiskal me synim zgjerimin e bazës së tatimit dhe minimizimin e informalitetit, pasi, siç do ta shihni edhe në prezantimin e ligjeve në vijim të paketës fiskale, paketa fiskale është minimaliste, krahasuar me paketat fiskale të viteve të kaluara dhe ka synuar,

madje në disa aspekte që lidhen me fokusin e komisionit është lehtësuese, si në fushën e bujqësisë, dhe ka synuar një qëndrueshmëri fiskale të kërkuara edhe nga forumet e biznesit.

Projektbuxheti, siç jua thashë, parashikon një shpenzim prej 736 miliardë lekësh ose 30% të prodhimit të brendshëm bruto, me një rritje absolute prej 30 miliardë lekësh krahasuar me planin e rishikuar nga akti normativ ku u pa një rritje e të ardhurave në vitin 2023.

Si pikë kyçe e buxhetit është mbështetja për një rritje domethënëse të pagave, duke bërë të mundur që brenda vitit 2024 të realizohet objektivi i vendosur për të arritur një pagë mesatare prej 900 eurosh në muaj. Projektbuxheti parashikon rritjen e mëtejshme të pagave të mjekëve të përgjithshëm, të infermierëve dhe të punonjësve të tjerë të shëndetësisë, të mësuesve, të forcave të rendit, të forcave të mbrojtjes, si dhe të niveleve zbatuese të administratës qendrore dhe vendore. Në total reforma e pagave kap një vlerë prej afro 400 milionë euro, vlerë, e cila është konstante, sepse vijon edhe në vitet në vazhdim.

Gjithashtu, financohet indeksimi i pensioneve, i cili gjatë 2 vjetëve të fundit kap shifrën rreth 25 miliardë lekë ose mbi 220 apo 230 milionë euro. Vijon mbështetja për mbrojtjen sociale dhe shtresat në nevojë, ku mbi 1/3 e buxhetit shkon për kategorinë e mbrojtjes sociale, ku përfshihet skema e pensioneve, ndihma ekonomike, pagesa e paaftësisë, pagesa e papunësisë, asistencë sociale, ish-të përndjekurit, ish-pronarët e kështu me radhë.

Ndërkohë, ruhet financimi i investimeve publike mbi nivelin 5,3% të prodhimit të brendshëm bruto, duke mbajtur parasysh që 5% e prodhimit të brendshëm bruto për investimet publike konsiderohet si një tavan i shëndetshëm i investimeve publike në një buxhet të caktuar me synimin për të mbështetur më tej rritjen ekonomike, për të zhvilluar turizmin, bujqësinë dhe konektivitetin, si dhe për të nxitur punësimin. Paketa e investimeve mbështet infrastrukturën kombëtare dhe vendore për t'iu përgjigjur sa më mirë edhe kërkesës në rritje të turizmit.

Në total, investimet shkojnë në 128 miliardë lekë për vijimin e projekteve të rëndësishme infrastrukturore në linjë edhe me strategjitë sektoriale të zhvillimit. Në këtë fond përfshihet edhe procesi i rindërtimit në shumën 7 miliardë lekë. Në planifikimin e investimeve për vitin 2024, fokusi mbetet te financimi i projekteve në fushën e transportit rrugor, hekurudhor, zhvillimi urban dhe rajonal, ujësjellës-kanalizimet, trashëgimia kulturore, turizmi e të tjera.

Më specifikisht, në fushën e infrastrukturës është planifikuar një buxhet prej 52,7 miliardë lekësh ose 2,2% e prodhimit të brendshëm bruto, ku prioritet në periudhën afatmesme 2024-2026 kanë një sërë projektesh. Ndër to unë do të veçoja, jam i bindur se në momentin që

ministrja do të dëgjohej nga ju do t'jua sqaroj më në detaje: tunelin e Llogorasë, që parashikohet të përfundojë në vitin 2024, duke përmirësuar më tej infrastrukturën dhe aksesin në bregdetin e Jugut; vijimin e zgjerimit të aksit Elbasan-Qafë Thanë; projektet e hekurudhës Tiranë-Rinas dhe Tiranë-Durrës, që vazhdojnë të mbështeten; do të fillojë hekurudha Vorë-Hani i Hotit me një vlerë të plotë prej afro 400 milionë eurosh, që është mbështetur në një pjesë të konsiderueshme edhe me grant, nëpërmjet WBEF-it dhe është planifikuar si një investim me financim të huaj. Gjithashtu, ka një portofol investimesh në programin “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, si dhe “Infrastruktura bashkiake”, ku vlera shkon në 8,8 miliardë lekë për vitin 2024.

Në fushën e turizmit synohet diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor, por do të shtoja edhe gjithëhapësinor, sepse po shohim që ka turizëm jo vetëm në bregdet, por edhe në pjesën e brendshme të vendit dhe në zonat lumore. Synohet zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, i ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, duke e shtrirë këtë shërbim në të gjithë vijën bregdetare; zhvillimi i produkteve dhe të shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i imazhit, duke financuar evente të rëndësishme promovuese; mbështetja e projekteve për Parkun Kombëtar të lumit Vjosa, si dhe të rrjetit të shtigjeve në zonat e mbrojtura në kuadër të një nisme, siç jua thashë, për turizëm gjithëvjetor dhe gjithëhapësinor.

Në sektorin e bujqësisë projektbuxheti parashikon vlerën prej 14,2 miliardë lekësh, vitin e ardhshëm, ku përfshihet mbështetja me 2,1 miliardë lekë e skemës kombëtare të fermerëve, duke e rritur numrin e përfituesve nga kjo skemë, si dhe mbështetjen me 1,3 miliardë lekë të skemës së subvencionit të naftës, e cila po ashtu projektohet me rritje sa i përket numrit të përfituesve, në rreth 32 mijë për vitin 2024.

Ju kujtoj këtu që me aktin normativ ne i dhamë një mbështetje të ndjeshme të dyja këtyre skemave me shumën 1,8 miliardë, e cila pritet të shpenzohet deri në fund të këtij viti, duke krijuar mundësinë që viti i ardhshëm të nisë pa risk, pra pa detyrime të prapambetura, por të adresojë vetëm kërkesat e reja.

Gjithashtu, administrimi i sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve është ajo që adresohet nëpërmjet buxhetit të bujqësisë, duke parashikuar financime që mbështesin përmirësimin e ujitjes. Në projeksionet e Ministrisë së Bujqësisë ato e përmirësojnë ujitjen në rreth 8000 hektarë.

Në fokus ka qenë siguria e digave ujëmbledhëse, për të cilat alokohen rreth 600 milionë lekë shtesë për të monitoruar sigurinë e digave, si dhe duke planifikuar një fond, krahas fondit që i shkon Ministrisë së Bujqësisë, i cili do të ketë në këtë aspekt edhe rritje të punonjësve për sigurinë e digave. Gjithashtu, planifikohet edhe një fond prej 500 milionë lekësh në zërin e emergjencave civile për bashkitë.

Më tej janë investimet në fushën e zhvillimit rajonal. Pra, Fondi Shqiptar i Zhvillimit parashikohet të ketë një buxhet total në masën 16,5 miliardë lekë, të fokusuara kryesisht në projektet e integruara zhvillimi që ndihmojnë turizmin vendor dhe infrastrukturën rurale.

Më tej, nëpërmjet projektbuxhetit parashikohet t'u jepet mbështetje bizneseve të reja, kryesisht *start-up*-ve, ku parashikohen një fond prej rreth 550 milionë lekësh për skemat e mbështetjes në këtë fushë.

Sa i përket buxhetit vendor, edhe për këtë nivel qeverisjeje ka një rritje domethënëse prej 10,4% në raport me buxhetin e vitit 2023, parashikuar në total në masën 71 miliardë lekë, duke zënë afro 3% të prodhimit të brendshëm bruto. Këtu një pjesë e rëndësishme është granti i qeverisjes qendrore për njësitë vendore, në masën 36,5 miliardë lekë, pra më shumë se gjysma e totalit të buxhetit të pushtetit vendor jepet grant nga pushteti qendror dhe ku transfertat e pakushtëzuar për vitin 2024 është në masën 24,3 miliardë lekë.

Ndërkohë, përveç transfertave të pakushtëzuara dhe të ardhurave të veta përfshihet portofoli i mbështetjes nëpërmjet ministrive të linjës, ku parashikohen 15,3 miliardë lekë. Konkretisht, për investime në rikonstruksion, ndërtim ujësjellësish për bashkitë në vlerën 4,5 miliardë lekë; investime, siç jua përmenda, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit; fondi për emergjencat lidhur me parandalimin e fatkeqësive natyrore; investime për rikonstruksion dhe rehabilitim shkollash në 2,2 miliardë lekë; investime për ujitje dhe kullim; fondi social e kështu me radhë.

U fokusova më tepër te fushat që janë në spektrin e komisionit, për t'u kthyer tashmë në kontekstin makro. Ne parashikojmë një deficit prej 2,5% sa i përket buxhetit të vitit të ardhshëm me një balancë primare pozitive, që do të thotë se duke përjashtuar interesat e borxhit balanca midis të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të dalë pozitive për të siguruar një ulje të mëtejshme të borxhit publik. Ky tashmë është një rregull i vendosur në ligjin organik të buxhetit, i cili besojmë se do të arrihet që me rezultatin e këtij viti financiar dhe na siguron, siç jua thashë, që për të herë të parë, që nga vitin 2011, në vitin e ardhshëm të kemi një borxh publik nën nivelin e

60% të prodhimit të brendshëm bruto, çka na jep mundësinë që të konsiderohemi si një vend me financa publike më të qëndrueshme dhe më të shëndetshme.

Shumë faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Ministër!

Në fakt, ne do të kemi në ditët dhe javët në vijim edhe dëgjesat me ministrat përkatës të linjës që ne mbulojmë. Gjithsesi, unë ju falënderoj për përshkrimin që i bëtë buxhetit qoftë në termat makro, qoftë edhe në detajet e fushave që mbulon komisioni ynë!

Përpara se t'ia kaloj fjalën relatorit Duraj, më lejoni t'ju bëj një listim të deputetëve që marrin pjesë: zoti Baftjar Zeqaj, zoti Ismet Beqiraj, zoti Laert Duraj, zoti Nusret Avdulla, zonja Elona Bilali, zoti Fadil Nasufi, zoti Bujar Çela, zonja Mirela Pitushi, zoti Shkëlqim Bullari, zoti Gëzim Ademaj, zoti Anduel Tahiraj dhe zoti Ilir Ndraxhi.

Faleminderit!

Fjalën e keni ju, zoti Duraj, në rolin e relatorit, për të na folur për buxhetin e vitit 2024.

Laert Duraj – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Ashtu, siç e tha edhe kryetari, do të dëshiroja shumë që ky diskutim lidhur me projektbuxhetin (lajmi i mirë është që është sa dyfishi i atij të vitit 2013), do të ishte e udhës të bëhej në sallën e komisionit tonë, pasi në të kaluarën si komision ia kemi dalë mbanë që falë diskutimeve dhe ndërhyrjeve tona, aq sa e kemi pasur të mundur, të reflektonim dhe t'i përmirësonim gjërat. Opozita preferoi ndryshe. Mendimi ynë është i qartë në këtë pikë. Gjithsesi, edhe mënyrën që kemi zgjedhur e gjykoj shumë efikase, pasi ne mund të shprehim opinionet dhe mendimet tona në lidhje me projektbuxhetin.

Siç e tha edhe ministri, ky është një projektbuxhet i konsolidimit të vazhdueshëm të rritjes ekonomike të Shqipërisë. Projektbuxheti i vitit 2024, adreson sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet Shqipëria, ai synon një shpërndarje më të mirë të mirëqenies sociale, pasi vërtet synimi i rritjes së pagave, arritja e objektivit tonë për vitin 2024, tashmë është më afër se kurrë. Unë mendoj se mirëqenia sociale, që është synuar në këtë rast, jo vetëm do ta përmirësojë jetën e vendit, por do të përmirësojë edhe klimën e shoqërisë sonë nëpërmjet konsumit, gjë, që pa diskutim do të sjellë edhe një zhvillim më të madh të ekonomisë, duke synuar kështu, në këtë mënyrë forcimin e kërkesës së brendshme; do të krijojë punësim cilësor dhe do të krijojë premisat për një të ardhme më të mirë dhe më të sigurt.

Ndërkohë, nga ana tjetër, siç u përmend edhe nga ministri, synohet konsolidimi fiskal. Mjafton fakti që borxhi të ulet në nivelin 60% dhe për ne shqiptarët, duke u nisur nga fakti që ndikohemi edhe nga ekonomia, edhe nga fqinjët tanë (kam parasysh rastin e Greqisë), as që mendohej të synohej ky nivel borxhi. Kështu që, unë kam veçse fjalë të mira për punën e bërë nga qeveria dhe nga Ministria e Financave në veçanti.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet që, pas recesionit të fortë prej - 3,3 % të vitit 2020, për arsye që tashmë i dimë të gjithë, ekonomia jonë të vazhdojë me ritmet e saj të rritjes, madje synohet që në vitin 2024 rritja të jetë rreth 3,8-3,9%, një rritje goxha e mirë në krahasim edhe me vendet e rajonit.

Gjithashtu, deficitet buxhetor është planifikuar të jetë në nivelin 2,5% të PBB-së, pak më i madh se ai i vitit 2023. Kjo lidhet edhe me faktin se është rritur prodhimi në vlerë, në përqindje, por edhe për shkak se prodhimi i përgjithshëm bruto synohet të rritet më shumë në vitin 2024.

Të ardhurat buxhetore në raport me prodhimin e përgjithshëm bruto në buxhetin e parashikuar janë në nivelin e 27,8%, pra afërsisht 1% më shumë se viti 2023, që në termat financiarë është një vit jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Gjithashtu, shpenzimet janë parashikuar në nivelin mesatar 30,2% të nivelit të përgjithshëm dhe, siç e tha dhe zoti ministër, rreth 5% e prodhimit të përgjithshëm bruto synojnë të mbulojnë investimet në infrastrukturë.

Një lajm i mirë për të gjithë ne, kolegë, që jemi shumë të lidhur me zonat tona, lidhet me trajtimin dhe rritjen e shpenzimeve në mënyrë të rëndësishme për pushtetin lokal. U përmend transferta e pakushtëzuar, shifrat i tha zoti ministër, megjithatë dua të sjell në vëmendjen tuaj një fakt, që në krahasim me vitin 2015, kur reforma territoriale, reforma e pushtetit lokal, filloi implementimin e saj, kjo shifër është 92% më e lartë, praktikisht afër 100%. Kështu që, edhe ky fakt është shumë i rëndësishëm, sidomos për fushat e veprimtarisë që komisioni ynë mbulon - kam parasysh bujqësinë dhe turizmin. Këto investime janë ngushtësisht të lidhura edhe me performancën e operatorëve turistikë në të gjithë territorin.

E gjithë kjo qasje, që buxheti i shtetit ka ndaj ekonomisë shqiptare, vjen në një moment kur klima është më se pozitive. Vlerësimi i institucioneve ndërkombëtare të përmendura këtu është fakt, që na bën krenar të gjithëve, por ka dhe shumë elemente të tjera që janë tregues i qartë i performancës pozitive. Mjafton të përmendet fakti që rritja turizmit në nivelet mbi 30% në krahasim me vitin 2023 është një shenjë e mirë.

Sa i përket sistemit tonë bankar, dua të sjell në vëmendjen tuaj faktin që performanca ka qenë jashtëzakonisht e mirë qoftë në rritjen e depozitave, qoftë në rritjen e stokut, i cili në raport me vitin 2023 sidomos sa u përket bizneseve është rritur në masën 70,2%. Pra, edhe sektori bankar ka performuar shumë mirë.

Rritja e vlerësimit, rritja e cilësisë së ekonomisë dhe mënyra si operon kanë rritur edhe besimin e shqiptarëve që banojnë jashtë kufijve, pasi rreth 18% më shumë është rritur volumi i remitancave që ata kanë depozituar, kanë sjellë në Shqipëri.

Nuk do të ndalem më shumë në shifra, por vetëm do të sjell faktin që në raport me ekonominë e rajonit performanca e ekonomisë sonë ka qenë jashtëzakonisht pozitive dhe në shumë elemente të saj ka qenë më e mira, sidomos në raport me rritjet në krahasim me 4 vjet më parë.

Shpresoj shumë që gjatë diskutimeve që do të kryhen në komisionin tonë nga ministrinë e linjës të dalin shumë elemente dhe shumë vlerësime apo qasje të tjera, megjithatë unë dua të bëj komplimentet maksimale për punën e kryer nga Ministria e Financave në materialin e paraqitur pranë nesh, për qasjen shumë pozitive, e cila përfshin më së miri çdo element të ekonomisë sonë.

Gjithashtu, dua të falënderoj edhe hartuesit e projektbuxhetit! Dua të shtoj diçka që e përmendi edhe ministri: është pak rajonale, por ne nuk heqim dorë, në këtë projektbuxhet lumi i Vjosës është qartësisht i rëndësishëm dhe i marrë në konsideratë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

A ka pyetje apo diskutime në lidhje me projektbuxhetin?

Zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Diskutimin e projektbuxhetit për vitin 2024 unë do ta konsideroja si një ngjarje shumë të rëndësishme në jetën dhe veprimtarinë jo vetëm të institucionit kryesor, që është Kuvendi, që e shqyrton dhe e miraton atë, por është një ngjarje edhe për të gjithë qytetarët shqiptarë, pasi, si në një familje të madhe, edhe në familjen e popullit tonë ne bëjmë bilancin e asaj që kemi realizuar: ato që janë bërë dhe ato që parashikohen të bëhen.

Ndaj keqardhje edhe për pjesën tjetër opozitare, të cilët janë të detyruar të japin kontributin e tyre me vërejtjet e tyre, me sugjerimet e tyre, sepse buxheti nuk bëhet vetëm për një

pjesë të popullsisë, nuk bëhet vetëm për socialistët apo për mazhorancën, por bëhet për të gjithë popullin.

Unë do të ndalesha në disa prej risive të projektbuxhetit të vitit 2024. E them me plot gojën: sinqerisht ndihem krenar që jam pjesë e deputetëve në një kohë dhe në një moment kur ne diskutojmë një buxhet që e kalon shifrën e 7 miliardë eurove në vit. Pra, është një nga buxhetet më të mëdha në historinë e planifikimit buxhetor të vendit tonë. Këtë sinjal sigurisht e dha edhe oferta e madhe turistike, e cila nga parashikimet tona mendohej që ne ta kapim atë objektiv në vitin 2030, me programin “Shqipëria 2030”, por ja që ofertën turistike e kapëm që në vitin 2023.

Së dyti, ky buxhet mbështet edhe atë shtresë të shoqërisë, që ne përfaqësojmë si forcë politike, ku 1/3-ta e buxhetit planifikohet për mbështetjen social-ekonomike, duke filluar me rritjen e pagave në sektorin publik, të cilat impaktojnë detyrimisht edhe rritjen e pagave në sektorin privat, por edhe me mbështetjen ekonomike dhe financiare të shtresave të ndryshme sociale. Nuk do të përmend deficitin, sepse të prekësh dyshe-menë nën 60% është jo vetëm një risi shqiptare, por rajonale dhe më tej.

Për herë të parë, në mënyrë simbolike, projektbuxheti shoqërohet pas me një paktë fiskale modeste 10-15 milionë euro. Pra, janë disa gjera të detyrueshme për t’u korriguar, gjë që ne do t’i kalojmë edhe te pjesa e paketës fiskale.

Nga ana tjetër, unë si risi do të veçoja edhe investimet publike që janë planifikuar në masën rekord 5,3 të PBB-së, pra mbi 1,1 miliardë euro dhe më tepër, dhe në sektorë kritikë, strategjikë, që i japin një shtysë zhvillimi, siç janë portet, aeroportet, autostradat, hekurudhat e të tjerë.

Në vitin 2024 realizohet objektivi i pagës mesatare në sektorin publik dhe ky është një gjenerator shtesë plus jo vetëm për të impaktuar financat pozitive në skemat e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, por rrit edhe konsumin, rritet shpejtësia e qarkullimit të monedhës dhe në finale rriten edhe të ardhurat në buxhetin e shtetit.

Ndjesë, por në vlera të tilla që ne po diskutojmë për buxhetin kemi shumë për të folur! Në këtë buxhet qeveria, duke e vlerësuar sektorin e bujqësisë si një nga sektorët më të rëndësishëm, ku punon pjesa dërrmuese e shtetasve shqiptarë, që e duan tokën, e përdorin dhe e shfrytëzojnë atë jo vetëm për të mirën e tyre, por edhe të shoqërisë, vazhdon dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2024 me skemën mbështetëse të subvencionimit me naftë, duke e rritur me 1500 përfitues të tjerë, skemë e cila nga riallokimi i fondeve të këtij viti u mbyll me 31 mijë përfitues.

Kjo i nxjerr nga informaliteti, sepse i pajis fermerët me NIPT, duke ia ditur vlerën kooperimit, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në skemë.

Gjithashtu, edhe masat mbështetëse në bujqësi janë rritur, nga 7500 përfitues në vitin 2023 dyfishohet në 13 mijë e 900 përfitues.

Ajo që është më e rëndësishmja, edhe në kushtet që është bota, në krizë dhe me vatra zjarri lufte, edhe sektori i mbrojtjes dhe sigurisë për herë të parë realizon angazhimin si vend anëtar i NATO-s me 2% të buxhetit. Pra, 2% e GDP-së është e planifikuar jo vetëm për vlerësimin në aspektin e trajtimit ekonomik, financiar dhe social për ushtarakët, por edhe për të modernizuar me armatim dhe pajisje ushtrinë tonë.

Ndjeshë, por unë do të doja të bëja disa pyetje.

Pyetja e parë është ajo që u kam bërë gjithnjë ministrave të Financave kur kemi trajtuar buxhetin: përveç të ardhurave tatimore, doganore, ne kemi të ardhura edhe nga burime të tjera, siç është një nga sektorët me vëmendje të shtuar, edhe pas lajmit për vendburimin e ri që presim të vërtetohet në Shpirag, ne kemi rezerva gjeologjike në vendburimet ekzistuese, që janë dhënë me koncesion. Kemi dhe dy kompani “Alb Petrol” dhe “Alb Gaz”, ku rezervat gjeologjike, të vërtetuara, i kapin shifrat mbi 435 milionë tonë naftë realisht. Në të ardhurat e buxhetit të shtetit sa është kontributi që japin kompanitë, qoftë ato koncensionare, e naftënxjerrjes, por edhe të gaznxjerrjes në vendin tonë, qoftë ato publike?

Me paketën e rritjes së rrogave sigurisht që ndodhin ato faktorë që unë thashë më sipër, por ama, ta pranojmë, objektivi që do të realizohet për bërjen e pagës mesatare 900 euro në nivel kombëtar, rrit hendekun me pagën mesatare të pensionistëve. Sigurisht, bashkohem me të gjitha iniciativat edhe për vitin buxhetor të ardhshme, por a mjafton kjo vetëm me indeksimin e pensioneve dhe me bonuset në fund të vitit, në fillim të vitit, apo në mes të vitit, apo duhet të jetë një përmbysje edhe për pensionistët, ku minimalisht të përcaktohet qoftë dhe një nivel minimal? Ne duhet ta pranojmë, hendeku me rritjen e rrogave, duke filluar që nga administrata e lartë dhe pensionistët është thelluar dhe zgjeruar shumë.

Vendi ynë ndodhet në një situatë kritike për specialistë të mesëm. Në çdo shoqëri dhe në çdo vend raporti i specialistëve të lartë dhe të mesëm është 1 me 10, në favor të të mesmëve. Ata e ndërtojnë dhe zhvillojnë vendin. Sigurisht, arkitektët dhe ndërtuesit janë intelektualët. Meqenëse edhe rrjeti i shkollave të kualifikimit profesional varet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka ardhur momenti që ky raport të ndryshojë, pra të thyhet numri i atyre që shkojnë

në gjimnaz me ata që shkojnë në shollat profesionale, pasi profesionistët paguhen shumë mirë, sidomos në kompanitë e ndryshme private, por dhe nevojat shoqërore i kërkojnë më shumë. Dua të them se kurrikulat profesionale të formimit të arsimit profesional janë.

Unë kam fatin që kam qenë pjesëtar i tyre në shumë fusha të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit tonë dhe mbulojnë shumë sektorë.

Trupa mësimdhënëse, të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Financave, ende ekziston. Unë dua të them që intelektualët në pension le ta japin kontributin e tyre, sepse janë marrë tërë jetën me shkollat profesionale, mbase njeriu fizikisht vdes, por mendja nuk vdes, mbetet.

Nga ana tjetër, infrastruktura në rrjetin shkollor kërkon ngritjen e shkollave profesionale dhe ngritjen e rrjetit të shkollave profesionale, që të mbështesin industrinë e rëndë, ushqimore, burimet minerale, naftën dhe gazin. Unë jam nga zona e naftës dhe gazit, nuk ka shkolla, ose janë pak shkolla tradicionale, sepse pothuajse janë të mbyllura. Ndaj, në këtë infrastrukturë të shkollës e kemi nëpër bashki, por duhet investim dhe një edukim. Le të bëjmë edhe shkolla të bashkuara, siç janë bërë qëmoti, jo vetëm për industrinë, por edhe për veterinarinë dhe bujqësinë. Kjo duhet bërë sot, sepse nesër mund të jetë shumë vonë. Këtë e them me sinqeritet.

Unë e vlerësoj dhe e quaj risi që për herë të parë alokohen dhe parashikohen fonde për monitorimin dhe sigurimin e digave qoftë nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, qoftë edhe të organeve të qeverisjes vendore, që në total janë 1,2 miliardë lekë të rinj. Por në ndodhemi përballë ndryshimeve klimaterike, të cilat para bujqësisë paraqesin shumë sfida. Cila është një nga sfidat? Thatësira. Si do ta përballojmë? Nuk mund të na falet kur në vendin tonë kemi trashëgimi nga qeverisja e pas vitit 1944 mbi 620 basene ujore ose rezervuare në të gjithë Shqipërinë, të cilat flenë. Vetëm në Mallakastër janë 18, vetëm një shfrytëzohet, të cilat mund t'i përdorim për qëllime të trefishta: vaditje, uji të pijshëm dhe energji. Këto ishin pyetjet e mia. Dëshiroj të bëhet më e mira dhe sigurisht më e mira ka për t'u bërë!

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Beqiraj! Ju falënderoj për përmbledhjen dhe për pyetjet që bëtë. Dita ka qenë e lodhshme për të gjithë, kështu që, ju lutem, të jemi pak koncizë në pyetjet që bëjmë!

Zoti Ministër, fjala është për ju, për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetit Beqiraj.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit për pyetjet!

Po e nis me pyetjen e fundit për arsimin profesional dhe pastaj do t'i marrë me radhë, duke u ngjitur sipër.

Bashkohem me atë çka tha zoti Beqiraj që jo vetëm çështja e arsimit profesional, por në fakt çështja e *skills matching*, pra e përshtatjes së aftësive që ne po u japim nxënësve apo studentëve me nevojat e tregut të punës dhe në përgjithësi oferta e punës, është një nga çështjet që në afatmesëm, edhe për shkak të zhvillimeve demografike, do të jetë një çështje kryesore, si *pilar* i zhvillimit të ekonomisë. Në këtë kuadër, ndaj me ju që investimet në arsimin profesional janë rritur nga 360 milionë në vitin 2023 në 570 milionë në vitin 2024. Kjo do të thotë se janë rreth 5,5 milionë euro, të cilat do të shkojnë në investime të zërit të shkollave profesionale, ku nuk do të jenë vetëm shkolla, por, për shembull, në adresim janë edhe konvikte, sepse këto shpesh janë rajonale në qasjen e tyre.

Këtu ka edhe një fokus të shtuar nga donatorët me të cilët ne operojmë dhe sigurisht është e nevojshme që investimet e bëra në këtë drejtim të kenë edhe një qasje të zhvillimit rajonal, pra të lidhen edhe me zhvillimin rajonal të zonës, siç e përmendët edhe ju.

A mjafton indeksimi i pensioneve? Mbani parasysh që në 2 vjetët e fundit, duke qenë se indeksi i çmimeve, pra inflacioni i shportës, i pjesës që ndikon në indeksim të pensioneve, ka qenë i lartë, vlera totale e shifrës së indeksimit kap shumën e afro 230 milionë eurove dhe kjo është një shtesë e përrjetshme, sepse është për të gjithë kohëzgjatjen e pensionit. Parashikohet edhe një indeksim tjetër në tetor të vitit 2024 në vlerën afro 4,5 miliardë lekë, pra rreth 40 milionë euro të tjera.

Duke pasur parasysh mundësitë e buxhetit, duke pasur parasysh edhe faktin që skema subvencionohet nga buxheti i shtetit në afro 500 milionë euro subvencion çdo vit, indeksimi ka një peshë domethënëse. Sigurisht, unë po e ndaj me ju që ka ardhur koha kur skema e pensioneve të kalojë ndoshta në një fazë të dytë reformuese. Është bërë një reformë domethënëse në vitet 2014-2015, që ka ndihmuar soliditetin dhe funksionimin e skemës, dhe mendoj se në vitet 2024-2025, pra pas 10 vjetësh, duke pasur parasysh edhe zhvillimet demografike, duke pasur parasysh edhe të dhënat që do të dalin nga censusi, duke pasur parasysh edhe zhvillimet makroekonomike, duhet të ketë një qasje analitike reformuese ndaj skemës së pensioneve. Për këtë jemi në diskutim qoftë me Bankën Botërore, qoftë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, për të parë një qasje sa më adekuate në lidhje me skemën e pensioneve.

Në çdo rast mbani parasysh që aty janë mbi 700 mijë pensionistë. Nga ana tjetër kemi rreth 160 mijë në skemën e paaftësisë, pra pak persona me aftësi të kufizuara, kemi mbi 60 mijë, rreth 70 mijë, familje me asistencë, pra me ndihmesë papunësie, për një total prej mbi 1,1 milionë personash që përfshihen në skemat e *entitlements*, pra në skemat e mbështetura nga shteti në frymën e mbrojtjes sociale, pa përfshirë këtu ish-pronarët, ish-të përndjekurit e kështu me radhë. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh edhe numrin total të të punësuarve dhe të kontribuuesve, fakti që ky *social net*, pra ky rrjet dhe mbrojtje sociale, zë mbi 33%, pra mbi 1/3-ën e buxhetit, besoj se në kuadër të së tërës janë të ndjeshëm vullneti dhe mbështetja që po përpiqet t'u jepet këtyre skemave.

Sa u përket të ardhurave të kompanive të naftës, me të gjithë dëshirën që kam, për momentin nuk kam të dhëna të sakta se sa janë ato, por gjithsesi sot ne jemi duke e diskutuar në parim buxhetin. Besoj se përgjatë të gjithë këtij muaji do të kemi kohë ta diskutojmë qoftë me ministrat përkatës, qoftë edhe gjatë diskutimit nen për nen. Ajo që di t'ju them është se ne kryesisht mbledhim të ardhura nëpërmjet rentës minerare dhe renta minerare e planifikuar për vitin tjetër është afërsisht 2 miliardë lekë. Shtoj këtu që, në kuadër të sektorit energjetik, këtë vit u aplikua edhe një taksë, *windfall tax*, pra një taksë e aplikuar vetëm një herë nga prodhuesit e energjisë dhe e HEC-eve, në masën 8 miliardë lekë, pra ishte e ndjeshme, që u shpërnda si bonus për pensionistët dhe që ishte një ndihmesë e drejtpërdrejtë. Në fund të vitit ne parashikojmë të kemi edhe një bonus tjetër për pensionistët. Pra, ky do të jetë një vit ku do të ketë 2 bonuse, një nga *windfall tax* dhe një në fund të vitit. Kjo besoj se është shprehje edhe e ndjeshmërisë së buxhetit apo e qeverisë ndaj kësaj shtrese.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Ministër?

A ka pyetje nga ndonjë koleg tjetër?

Zoti Çela, fjala është për ju.

Bujar Çela – Përshëndetje!

Falënderoj ministrin për shpjegimin! Ndërkohë dua të ndërhyj për të kërkuar 2 sqarime.

E para, po shikoj se janë shumë ata të cilët përfitojnë nga kontributet në këtë shtet kaq të vogël, sipas shifrës që përmendi ministri, e cila kalon 1,1 milionë përfitues, ku përfshihen pensionistët, ata me aftësi të kufizuara e me radhë, por edhe personat me përkrahje sociale.

Në lidhje me problemin e rëndë të pensioneve, si dhe në lidhje me rritjen e pagës minimale, të cilën unë e shoh si zgjidhje, mendoj se ato duhen diskutuar në parim. Ministri është më i qartë për shifrat dhe për prognozën e shifrave për vitin që vjen. Pagën minimale unë e shoh si zgjidhje të të gjitha problematikave që vijnë më pas, si të pensioneve, por edhe të përkrahjeve të tjera, duke menduar që në vitin 2024 kjo pagë nuk duhet të jetë me lojëra “900 euro paga mesatare”, por duhet parë paga minimale, sepse faktikisht të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që, përveç të punësuarve në sistemin shtetëror, pra në ndërmarrje të pasurive publike pranë bashkisë, në ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, të gjelbërimit, të pastrimit dhe në sektorë të ndryshëm, ku merret ajo pagë që deklarohet, në çdo biznes të sektorit privat paga është joreale. Kam mendimin se, nga llogaritë që bëj me shifrat, me aq njohje sa kam, rritja e pagës minimale në 50 mijë lekë të rinj në muaj do të jetë burim për disa zgjidhje. Punëdhënësit do të deklarojnë më saktë dhe kontribuimi për pensionistët do të jetë më i plotë. A ka mundësi (dhe këtë e shoh si zgjidhje) që pensionistëve, të cilët paguhen me 10 mijë lekë deri në 15 mijë lekë, t’u shkojë pensioni minimal 20 mijë lekë? Më duket se ky është një rregullim i cili i shkon për shtat edhe nivelit. Pra, rrisim pagën maksimale, shikojmë pagën mesatare, por nuk shikojmë 2 shtresa, atë të punëtorëve që kontribuojnë drejtpërdrejt dhe të pensionistëve, të cilët janë përfitues, si pasojë e kontributit që kanë dhënë ndër vite. Nëse ministri e sheh se sa përqindje zënë pensionet e ulëta dhe sa plotësohet rritja e pagës minimale, do të ishte një sihariq dhe një pozicionim shumë i vlerësuar i këtyre 2 shtresave në Shqipëri.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Çela!

Zoti Ministër, kishit diçka në lidhje me pyetjet, megjithëse ju e sqaruat pak më përpara?

Ervin Mete – Paga minimale është rritur 2 herë gjatë këtij viti. Pra, gjatë vitit 2023 ka pasur 2 rritje, për të arritur në nivelin prej 40 mijë lekësh të rinj ku është sot. Rritja e pagës minimale ka një sërë elementesh të cilat merren në konsideratë, përfshirë edhe impaktin që ka në rendimentin e punës, por edhe një sërë efektsh të tjera. Duke mbajtur parasysh që kursi i këmbimit, edhe në konvertim të pagës minimale me euron, në raport të kostove të punës, tashmë e bën pagën minimale më të lartë, ne do ta konsiderojmë një prekje të pagës minimale, por edhe të asaj maksimale, sepse ato janë të lidhura për efekt kontributesh, në raport analitik me të gjitha këto efekte që jep.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Nasufi, fjala është për ju.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit të gjithë ekipit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për paraqitjen kaq analitike të këtij buxheti!

Nuk dua të bëj shumë komente, por, siç e thashë, ky është një buxhet i shëndetshëm, një buxhet i rritjes ekonomike, një buxhet social, një buxhet që ka parasysh përmbylljen e projekteve dhe të prioritetëve kombëtare, një buxhet që për mua ka edhe një qasje me direktivat e Bashkimit Europian dhe është në akord me të gjitha rekomandimet e FMN-së dhe të Bankës Botërore për sektorët që duhet të jenë në vëmendje dhe për ata tregues, për të cilët foli në mënyrë të drejtpërdrejtë ministri, për uljen e borxhit dhe për të gjitha fushat që mbulon sipas ministrive.

Më vjen mirë që ka edhe projekte të cilat shkojnë drejtpërdrejt në respektim të asaj që quhet “Agjenda e gjelbër” dhe lajm shumë i mirë është investimi për hekurudhat, qoftë hekurudha Tiranë – Durrës, Rinas apo Vorë – Hani i Hotit, edhe në përmbyllje të projekteve që lidhin Shqipërinë me rajonin, por duhet të kemi parasysh që ne gjithmonë gjatë buxheteve shohim se çfarë do të përfitojmë në vitin pasardhës. Duhet të sjellim në vëmendje që po vijmë nga një vit shumë i vështirë, nga viti i krizës, e cila u përballua me shumë sukses, prandaj ky buxhet meriton shumë përgëzime nga ne, deputetët e mazhorancës, sepse qysh nga viti 2019 deri në vitin 2023 kemi qenë në kushte anormale dhe kemi ditur të administrojmë dhe të menaxhojmë situata shumë të vështira. Për këtë arsye, unë dua të jap mesazhin për çka ne i shtojmë buxhetit, sepse shifrat janë shifra. Ne buxhetit i shtojmë administrimin e kohës, mosvrasjen e kohës, prandaj është shumë mirë që keni këtë shpejtësi në reagimin nëpër komisione, me qëllim që buxhetin ta bëjmë efektiv një orë e më parë, duke e kaluar nga komisionet në seancë parlamentare dhe pastaj në zbatimin direkt nga sektorët. Të vrasim dembelizmin, parazitizmin, informalitetin, sepse nuk jemi këtu thjesht për të ngritur dorën për shifrat që vijnë, por për të nxitur të gjithë shoqërinë, të gjitha bizneset, të gjithë qytetarët shqiptarë që të jetë taksapagues të rregullt dhe pastaj përfitues të këtyre taksave nëpërmjet investimeve dhe të gjithë programit buxhetor të qeverisë.

Gjithashtu, kam edhe 2 pyetje për të shtuar. E para ka të bëjë me dhënien e pagave, të parashikuara të buxheti, edhe për ato kategori të cilat kanë fituar status nga Kuvendi, siç janë, për shembull, punonjësit e ish-kombinatit mekanik të Poliçanit apo të Çekinit, pra të ish-reparteve

mekanike ushtarake. Së dyti, qeveria vendore, qysh para reformës, ka trashëguar borxhe që mbarten, të cilat në fund të fundit qarkullojnë si shifra borxhesh. Realisht, çfarë do të bëhet me to? Si do të fshihen këto borxhe? Si do të eliminohen nga tabelat e paraqitjes së buxheteve?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Zoti Ministër, ju lutem, fjala është për ju. Ju jeni lodhur gjithë ditën, në fakt.

Ervin Mete – Nuk ka problem, por unë kërkoj ndjesë, sepse thjesht nuk e kuptova pyetjen e parë! Nëse është e mundur, ta përsërisë zoti Nasufi!

Arben Pëllumbi – Zoti Nasufi, ju lutem!

Fadil Nasufi – Pyetja lidhet me kategoritë e disa punonjësve që kanë fituar status nga Kuvendi, siç janë punonjësit e ish-kombinatit ushtarak të Poliçanit apo të reparteve ushtarake, të cilët nuk i kanë marrë pagat. Pra, është vendosur që ata do të paguhen, kanë marrë edhe statusin e veçantë me ligj të veçantë në Kuvend, por po kalon një vit e gjysmë dhe ata nuk i kanë marrë pagat e prapambetura, megjithëse u është premtuar.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Ervin Mete – Pyetja është shumë specifike. Në dijeninë time ka qenë një diskutim për një projektligj, por nuk e di nëse është finalizuar. Nuk besoj se është finalizuar. Ata kanë pasur një status të ndërmarrjeve apo të sh.a.-ve, të cilat duhet të trajtoheshin sipas buxhetit të tyre. Në dijeninë time, është Ministria e Mbrojtjes e cila po e ndjek këtë çështje. Projektbuxheti nuk parashikon zë të veçantë për pagat e këtyre ndërmarrjeve, edhe pse projektbuxheti parashikon zërat buxhetor në makro brenda ministrive, pastaj detajimi bëhet posaçërisht aty. Kështu që, nuk kam një përgjigje për këtë çështje, sepse është shumë specifike. E theksoj edhe një herë që po e diskutojmë buxhetin në parim dhe për një muaj e pak do të kemi mundësi ta diskutojmë edhe nën për nen, edhe sipas ministrive.

Arben Pëllumbi – Atëherë, faleminderit, kolegë!

Meqenëse nuk ka dikush tjetër për të diskutuar kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjeve të paketës fiskale:

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” (*Komision për dhënie mendimi*);

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”” (*Komision për dhënie mendimi*);

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”” (*Komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Nusret Avdulla, Bujar Çela, Gëzim Ademaj, Shkëlqim Bullari, Mirela Pitushi dhe Edona Bilali.

Mungojnë:

Helidon Bushati, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Flamur Hoxha, Lefter Gështenja, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Luan Baçi, Qani Xhafaj dhe Lodovik Hasani.

Të ftuar:

Ervin Mete – ministër i Financave dhe Ekonomisë

Vasilika Vjetro – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Arben Pëllumbi – Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, prezantimi i projektligjeve të paketës fiskale. Kush do ta bëjë prezantimin, ju, zoti Ministër, apo zonja Vjero?

Ervin Mete – Do të vijojë zonja Vjero.

Arben Pëllumbi – Atëherë, duke ju falënderuar dhe duke ju uruar një vazhdim të mbarë të punës për të gjithë llogaridhënien për buxhetin në këto ditë, ju uroj natën e mirë dhe faleminderit!

Ervin Mete – Ju faleminderit! E vlerësoj shumë!

Arben Pëllumbi - Fjala për zonjën Vjero.

Vasilika Vjero – Kryetar, me cilin projektligj do të fillojmë?

Arben Pëllumbi - Ne kemi 3 projektligje: për taksat kombëtare, për akcizat në Republikën e Shqipërisë dhe për TVSH-në, kështu që mund të filloni me këtë doni.

Vasilika Vjero – Po filloj me propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar””. Ky propozim, në fakt, parashikon rritjen, sipas një kalendarit 7-vjeçar, të taksës së karbonit për qymyrin, si dhe përfshirjen në taksën e karbonit edhe të disa nënprodukteve dhe formave të tjera të qymyrit. Këto ndryshime përfaqësojnë hapat e nevojshëm në kuadër edhe të hartimit të një kuadri ligjor sa më të plotë, mbështetur edhe në angazhimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe frenimin e ndryshimeve klimaterike. Përkatësisht është ligji nr. 91/2018 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit, i protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, i cili do të bëjë të mundur që masa e barrës fiskale që duhet të paguhet nga subjektet për çlirimin e dioksidit të karbonit në atmosferë nga djegia e qymyrit për prodhimin e produkteve, si: hekur, çimento, ferrokrom e të tjera të ngjashme me to të paguhet në Republikën e Shqipërisë dhe jo në shtetin ku do të eksportohet produkti apo nënproduktet e tij.

Pjesa e industrive, për të cilat do të aplikohet kjo masë janë ato industri, të cilat lidhen me prodhimin e çimentos apo të çelikut dhe zënë pjesën që përdorin më shumë qymyrgurin për prodhimin e këtyre lëndëve në formën e lëndëve djegëse.

Në fakt, me miratimin e rregullores nr. 956/2023 “Për vendosjen e një mekanizmi të rregullimit të kufirit të karbonit”, i cili ka hyrë në fuqi më 16 maj të po këtij viti, BE-ja ka vendosur aplikimin e një mekanizmi për të rregulluar kufirin e karbonit, i cili do të tanojë të gjitha importet drejt vendeve të BE-së nga shtete që nuk aplikojnë apo aplikojnë një taksë më të ulët karboni në tregun e tyre të brendshëm, krahasuar me atë se çfarë aplikon BE-ja. Për

rrjedhojë, duke filluar nga viti 2026 eksportet drejt BE-së të industrisë së çimentos, të çelikut apo edhe industri të tjera, të cilat çlirojnë karbon në natyrë gjatë procesit prodhues, do t'i nënshtrohen një detyrimi financiar të lartë për taksën e karbonit mbi qymyrin, me qëllim arritjen e një kufiri minimal të taksimit të çliruar në natyrë. Kufiri minimal i taksimit është përcaktuar, në fakt, edhe nga një vlerësim që ka bërë FMN-ja së fundi për produktet që çlirojnë dioksid karboni, që është 60 dollarë për ton/dioksid karboni të çliruar në lidhje me kostot e ngrohjes globale.

Meqenëse vendi ynë taksën e karbonit të qymyrit e aplikon në njësinë lekë për kilogramë dhe jo mbi sasinë e karbonit të çliruar në atmosferë, atëherë, nëse kufirin minimal të taksimit të karbonit do ta përkthejmë në lekë për kilogramë, do të rezultojë se niveli minimal i taksës së karbonit mbi qymyrin duhet të jetë të paktën 15,3 lekë për kilogram qymyr, nga 3 lekë për kilogram qymyr që është sot. Pra, ky do të jetë kufiri që kompanitë duhet të paguajnë në rastin që do të eksportojnë produktin për në vendet e BE-së, me synimin dhe me qëllimin që të mos taten atje në momentin kur këto produkte do të eksportohen.

Siç e përmenda në fillim, ne kemi parashikuar një kalendar të shtrirjes së ngarkesës fiskale për një periudhë 7-vjeçare, duke filluar nga viti 2024 deri në vitin 2030, kur ngarkesa fiskale do të jetë e plotë, dhe rritja e propozuar e taksës do të fillojë që prej vitit të ardhshëm dhe do të jetë 0,5 lekë për kilogram qymyr deri në 12,3 lekë, që do të jetë ngarkesa e plotë në vitin 2030, duke bërë kështu që taksa totale e karbonit të arrijë nga 3,5 lekë në vitin 2024, në 15,3 në vitin 2030.

Ne kemi parashikuar edhe efektet që do të shoqërojnë pikërisht këtë ndryshim në legjislacion. Efektet në të ardhura do të jenë pozitive, do të kemi një shtesë rreth 170 milionë lekë, por, sigurisht, synimi në këtë rast nuk është arkëtimi i të ardhurave, pasi të ardhurat shtesë që do të taten janë të ardhura simbolike, por e rëndësishme është që të kemi një nivel taksimi, i cili do të mundësojë që në momentin kur kompanitë shqiptare do të fillojnë të eksportojnë, me hyrjen në fuqi edhe të Rregullores së BE-së, të mos taten me vlerën maksimale në BE, por të taten brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Sigurisht, efektet pozitive do të jenë të lidhura edhe me përmirësimin e sasisë së dioksid karbonit, i cili do të lëshohet në natyrë.

Kjo ishte përmbajtja e këtij projektakti në vija të përgjithshme.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zonja Vjero!

Zoti Duraj, fjala për ju.

Laert Duraj – Pas sqarimit të plotë të zonjës Vjero nuk kam asgjë për të shtuar, por thjesht do të doja të ndaja me ju faktin që ne jemi komision për mjedisin dhe sipërmarrjen, dhe, nga njëra anë, sigurisht na vjen mirë që vendosja e taksave të karbonit është një fakt, që do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, dhe, nga ana tjetër, sigurisht që rriten kostot e atyre kompanive që punën e tyre e kanë të lidhur me karbonin.

Nga njëra anë, siç e tha edhe zonja Vjero, ne kemi detyrimet që na takojnë sa i përket integritit në BE, bazuar në rregullore, që ka të bëjë me vendosjen e një mekanizmi të kufirit të karbonit. Duam apo nuk duam ne, eksportet do të taten më shumë për ato vende ndaj të cilave nuk aplikohet kjo taksë karboni e unifikuar me marrëveshjen e Montrealit, që do të thotë se nëse nuk do të paguhen në Shqipëri, ato taksat do të merren kur të hyjnë në BE. Kështu që, sigurisht është më mirë që ato të merren në Shqipëri edhe sa i përket qasjes ekonomike, por edhe mbrojtja e mjedisit gjithashtu ka prioritetin e vet.

Ndërkohë, nga ana tjetër, duhet theksuar se kjo qasje e Europës nuk është vetëm për Shqipërinë, është për çdo vend. Kështu që, rritja prej 0,5% e taksës së karbonit çdo vit nuk do të ketë një ndikim aq të madh në koston e produkteve për ato kompani që janë të lidhura drejtpërdrejt me karbonin, pasi do të aplikohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha vendet. Kështu që, në raport me konkurrencën mendojmë se kjo taksë nuk do të ketë ndonjë efekt të rëndësishëm në kostot e produktit, për rrjedhojë edhe në mbarëvajtjen e përditshmërisë së tyre.

Mendoj se në total është një iniciativë për t'u përgëzuar, ndaj ftoj kolegët që ta mbështesin pa asnjë dyshim.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Në fakt, ju e thatë që ne si komision jemi këtu në të dyja krahët e peshores, pra duhet të mbështesim edhe iniciativat për mjedisin, por në krahun tjetër të kemi vëmendje të shtuar edhe për sipërmarrjet. Politikat mjedisore tashmë, me këto ndryshimet klimatike që i përmendin të gjithë, që janë të prekshme dhe po i shohim çdo ditë, sigurisht që marrin një rëndësi shumë të madhe, dhe nuk janë politika vetëm shqiptare, por mbarëbotërore, në mënyrë të veçantë të BE-së.

Ju e thatë, kjo rritje nuk është vetëm për tregun shqiptar, por do të jetë edhe për tregun europian, ku edhe konkurrojmë me eksportet tona, për rrjedhojë nuk është se do të ndihet në mënyrë të drejtpërdrejtë efekti i konkurrencës. Është për t'u përgëzuar iniciativa e Ministrisë së Financave për ta skeduar tashmë këtë rritje në vitet e para, në mënyrë shumë të ulët dhe të

pandjeshme, që edhe bizneset shqiptare të mund ta gjejnë veten e tyre me kostot, me riorganizimet dhe në fund të këtij ndryshimi të jenë në ato nivele që duhet të edhe BE-ja pas vitit 2026.

Ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët?

Sikurse e dini, ne në përgjithësi kemi zhvilluar së bashku edhe dëgjuesën, edhe votimin, por kryesia e komisionit këtë vit ka gjykuar që ne do të bëjmë t'i gjitha dëgjesat, do të dëgjojmë edhe ministrinë e linjës, pastaj do të kemi edhe një mbledhje të veçantë ku do të votojmë projektbuxhetin në parim dhe nen për nen, po ashtu edhe paketën ligjore në parim dhe nen për nen.

Vazhdojmë me pikën tjetër.

Zonja Vjero, vazhdojmë me projektligjin tjetër?

Vasilika Vjero – Faleminderit, kryetar!

Po kaloj te projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është kufizimi i nivelit të indeksimit dyvjeçar të tarifave të akcizës si rezultat edhe i detyrimit ligjor për indeksimin e tyre me normën zyrtare të inflacionit. Kjo është një kërkesë, e cila rrjedh, pikërisht, nga ligji bazë “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ku në nenin 18 është parashikuar ky detyrim për indeksimin automatik të tarifave specifike të akcizës çdo dy vjet me normën zyrtare të inflacionit.

Konkretisht, ne propozojmë kufizimin e indeksimit të tarifave specifike të akcizës brenda limiteve të një norme të inflacionit të akumuluar dyvjeçare që nuk i kalon 1,5%, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve, të cilat kanë një kalendar, i cili është miratuar tashmë për periudhën 2022-2026.

Pikërisht, ne kemi propozuar këtë indeksim, i cili nuk kalon më shumë sesa 5% për faktin se tashmë e dimë se si ka ndryshuar inflacioni në vite, pra ne e dimë që do të duhet të marrim masa për të shmangur një rritje jonormale të akcizave, si një masë kufizuese, e cila rrjedh edhe nga normat e inflacionit, të vlerësuara dhe të bëra të njohura vitet e fundit. Pikërisht, rritja shumë e shpejtë e inflacionit, në nivele jo normale, me një normë mesatare vjetore 7,4% në fakt i referohem vitit 2022, dhe 5,2% për periudhën janar-gusht të vitit 2023, është një fenomen, i cili nuk është vetëm fenomen shqiptar, por edhe global, që fillimisht u nxit nga efektet e pandemisë dhe më tej nga lufta në Ukrainë. Pikërisht, kjo rritje e shpejtë e inflacionit në këto nivele

jonormale bën të nevojshme që ne të rishikojmë edhe skemën e rritjes për produktet e akcizës, të cilat duhet të vlerësohen me normën e inflacionit. Në rast se nuk do të bëjmë një kufizim të normës së inflacionit, atëherë për vitin 2024 niveli i akcizave, duke filluar nga janari, do të rritet në masën 12,6%, çka do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e çmimeve të mallrave, siç mund të jenë karburantet, pijet alkoolike apo edhe produkte të tjera, për të cilat konsumatorët pa diskutim që janë shumë të ndjeshëm.

Efekti që ne parashikojmë të vijë si rezultat i indeksimit në masën 1,5% është në masën 0,5 miliardë lekë të ardhura vetëm nga ky indeksim në këtë masë me këtë normë të kufizuar.

Ky është një përshkrim i shkurtër i propozimit për ndërhyrjen që kemi propozuar në ligjin për akcizat.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Vjero!

Zoti Duraj, fjala për ju, por besoj se ky ligj është i qartë.

Laert Duraj – Qartësisht është një lajm i mirë jo vetëm për komisionin tonë, por për këdo. Ministria e Financave vjen me një propozim për të ulur detyrimet, gjë që tregon se ekonomia është vërtet në një fazë shumë të mirë. Ne e falënderojmë patjetër, sepse ne jemi komisioni i sipërmarrjes! Kjo jo vetëm që do të ulë kostot e produkteve apo të importit, por, nga ana tjetër, e mbron kompaninë nga ndryshimet e papritura në treg, pasi jetojmë në një kohë ku ndryshimet globale impaktojnë menjëherë çdo vend. Kështu që, normalisht, kushdo që është në atë fushë duhet ta dijë saktë sa do të jetë kostoja e produktit. Fakti që është vendosur tavanin maksimal 1,5%, e bën më të qartë për kompaninë, i bën më të mbrojtura ndryshimet në treg dhe normalisht i bën më të sigurt dhe më joshëse investimet në këtë fushë. Nuk ka dyshim që ne të gjithë, si komision, e përkrahim këtë nismë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Kalojmë te projektligji i fundit për sot.

Zonja Vjero, fjala për ju.

Vasilika Vjero – Faleminderit, kryetar!

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar” është projektligji i fundit i paketës fiskale. Në fakt, të gjitha këto ndryshime që propozojmë sot në këtë projektligj janë të lidhura drejtpërsëdrejti me masat që do të mbështesin

sektorin e bujqësisë. Ky projektligj synon nxitjen e importit të mëshqerrave, insekteve, përfshirë edhe bletët, me qëllim rritjen e numrit të krerëve në vendin tonë, zhvillimin e sektorit të bletarisë, stimulimin e prodhimit bio, duke eliminuar përdorimin e hormoneve dhe praktikave të tjera të zakonshme, si dhe përdorimin e metodave inovative në bujqësi për kontrollin biologjik të insekteve të dëmshme, e cila për rrjedhojë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së produkteve njëkohësisht edhe në përmirësimin e imazhin e produkteve vendase.

Ne kemi propozuar, së bashku edhe me ministrinë përkatëse, e cila i ka riparë me shumë kujdes propozimet e këtij projektligji, përjashtimin nga TVSH-ja në import për mëshqerrat e racës së pastër, përjashtimin nga TVSH-ja në import për bletët dhe përjashtimin nga TVSH-ja në import për insektet, të cilat zëvendësojnë pesticidet. Në fakt, janë tri masa, të cilat do të japin një efekt të munguar në buxhet në shumën 155 milionë lekë, por, nga ana tjetër, do të kenë një efekt tejet pozitiv në nxitjen e sektorit dhe të të gjitha kompanive, të cilat zhvillojnë aktivitetet në fushën e bujqësisë. Janë kërkesa, të cilat na janë bërë me dije edhe gjatë paketave fiskale të mëparshme, por që tashmë i sjellim edhe të materializuara.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Vjero!

Fjala për zotin Duraj.

Laert Duraj – Qartësisht rritja e kapaciteteve dhe kërkesës në treg, kam parasysh 1 milion turistë në Shqipëri, do të bëjë që edhe kërkesa për produktet ushqimore (mishi në këtë rast) është shumë e madhe dhe ndoshta ritmet e rritjes së ekonomisë sonë, sidomos asaj bujqësore, nuk mund ta përballojnë.

E kuptoj nismën e ministrisë, pra se çfarë synon të arrijë nëpërmjet uljes së këtij tatimi. Do të doja të shoqërohej edhe me një paketë tjetër masash, që kanë të bëjnë me nxitjen e produkteve vendase. Në komisionin tonë shpeshherë është ngritur si shqetësim kjo gjë, pra nxitja e ekonomisë bujqësore, incentivimi i tyre në mënyrë të ndryshme, të cilin patjetër që e mbështes personalisht, por do të doja që në projektbuxhet, kur të diskutojmë nen për nen dhe me Ministrinë e Bujqësisë, të shikojmë se si mund të impaktojë ekonominë tonë dhe se si shoqërohet kjo ulje e mirë e TVSH-së me nxitjen konkrete të atyre fermerëve, që aktualisht merren me mbarësitimin e racës së vendit, bletëve apo produkteve të ndryshme.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Në fakt, siç e shpjegoi edhe zëvendësministrja, ky është një propozim, i cili i vjen në ndihmë drejtpërdrejt fermerit shqiptar, duke përjashtuar nga TVSH-ja në import tri kategori, duke ndihmuar dhe duke dhënë një kontribut në nxitjen e rritjes së prodhimeve në këto fusha, qoftë në atë të mëshqerrave, qoftë në atë të bletarisë, por kjo duke zëvendësuar pesticidet me metoda më bio për mënyrën e luftimit të insekteve të dëmshme.

Kështu që, besoj se edhe ne si komision jemi shumë të interesuar që masa të tilla të vazhdojnë të gjejnë gjithnjë edhe më shumë mbështetje. Sigurisht, ju e thatë se kemi një buxhet tashmë të dyfishuar në raport me vitin 2013, që i jep mundësinë qeverisë, Ministrisë së Financave apo ministrive të linjës që të mund të bëjnë edhe politika të tilla.

Ka diçka nga kolegët për paketën fiskale? Nuk ka.

Zonja Vjero, ju falënderoj, për propozimet që bëtë!

Do të vazhdojmë mbledhjen sipas agjendës që kemi në postën tonë elektronike.

Ju falënderoj dhe ju uroj natën e mirë të gjithëve!

MBLEDHJA MBYLLET